Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**13.02.2023**	**24.02.2023**	**2023/0057**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me daten: 31.01.2023, OE "PHARMA LEADER L.L.C."- Prishtine, ka parashtruar ankese me nr: 2023/0057, kunder njoftimit per kontrate, kunder njoftimit per dhenie te kontrates ku eshte rekomanduar per kontrate OE "PHARMA LEADER L.L.C."- Prishtine, apo kunder anulimit te aktivitetit te prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim emergjent me Insulina Analoge nga Lista Esenciale" me nr. te prokurimit: "206-22-14292-1-1-5", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E SHËNDETËSISË. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të negocuar, lloji i kontratës: furnizim, , vlera e parashikuar e kontrat?s: 1,907,760.75 €. Lidhur me kete lende eshte nxjerr nje vendim i meparshem i OSHP - se Nr. 397/22, vendimi Nr. 409/22, si dhe vendimime Nr.596/22. Konform nenit 113, 114 te Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotesuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore te OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 - Qëllimi

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës

Neni 24 - Zyrtarët e prokurimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit

Neni 27 - Dosja e Tenderit

Neni 28 - Specifikimet teknike

Neni 35 - Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimittë kontratës

Neni 42 - Publikimi i njoftimeve

Neni 51 - Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

Neni 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 70 - Standardet për Sigurimin e Cilësisë

Neni 105 - Kompetencat e OSHP-së

Neni 108/A - Zgjidhja preiiminare e mosmarrëveshjeve

Neni 116 - Procedurat e vendim-marrjes

Neni 40 deri 50, i rregullores se KRPP-se 001/2022

Te nderuar,

Autoriteti Kontraktues - Ministria e Shendetedsise, më datën 18.01.2023, ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës për procedurën e ashtuquajtur **"Emergjente",pa** publikim <u>të njoftimit për kontratë, dhe ne njejten dite nenshkruan kontrate per aktivitietin e</u> prokurimit me titull **"Furnizim emergjent me insulina analoge nga lista esenciale',** me nr. prok: **206-22-1429-1-1-5.**

Arsyetimi se kontrata eshte Emergjente bie ndesh me veprimet e AK-MSH, pasi ata me date 19.12.2022 kane pergaditur Dosjen e Tenderit dhe ja kane derguar vetem Operatorit Ekonimik te preferuar, kurse me date 21.12.2022 therrasin per negocim te njejtin Operatore, te gjitha keto me preteksin se situata eshte "emergjente", pastaj per cudi, me nje muaj vonese, ne te njejten dite, me date 18.01.2023 pa i respektuar rregullat e LPP-se e publikojne Njoftimin per Kontrate dhe Njoftimin per Nenshkrim te Kontrates, ky fakt tregon se nuk eshte bere fjale per nevoje Emergjente per furnizim me keto produkte por qellimi i vetem ka qene Negocimi vetem me kete Operator Ekonomik, shkelje tjeter eshte se ne diten e negocimit eshte leshuar edhe vendimi i OSHP-se ku obligohet AK-MSH ta beje Rivleresimin e Tenderit qe eshte me procedure te rregullt per te njejtat produkte, por AK-MSH edhe pse ka pasur afat kohore 10 dite per te Rivleresuar lenden ajo edhe me tutje kur kane kaluar me shume se nje muaj nuk e zbaton kete vendim te OSHP-se, vendime te cilat jane obligative per cdo Autoritet Kontraktues, por perkundrazi bene shkelje te rende duke lidhur Kontrate te Negociuar pa publikim te Njoftimit per Kontrate.

Keto veprime te Zyrtareve te AK-MSH, tregojne se vendimeve te Autoritetit me te larte te prokurimit (OSHP) nuk i kushtojen aspak rendesi dhe vazhdojne me interesat e tyre personale, duke bere shkelje te renda te LPP-se.

Pretendimi -1.

Kompania jonë bazuar në dispozitat e nenit 108/A, të LPP-së, ka parashtruar kërkesë për ri shqyrtim të vendimit të AK-MSH.

Kerkesa per ri shqyrtim eshte dorezuar me daten 20.01.2023. Permes vendimit te AK-se kerkesa jone per ri shqyrtim refuzohet ne teresi si e pa bazuar.

Ne arsyetimin e te njejtes kerkese AK, gjithnje potencon se kemi te bejme me aktivitet tjeter te prokurimit dhe me ngulm tenton te arsyetoje kunderligjshmerin e te gjitha ketyre proceseve te prokurimit, perfshier edhe kontraten e fundit te quajtur si EMERGJENTE, duke u arsyetuar ne dispoziten e nenitn 35.2.1, (iii) te LPP-se.

Pikerisht kjo dispozit ligjore ne AK-MSH, shkelet pergjat procesit te 4 procedurave te prokurimt si emergjente dhe te pa publikuara, perkatesisht te negociuara vetem me nje operator ekonomik.

Neni 35.2.1 (iii), percakton: *"nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të **emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivisht të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues,** autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj. **Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neqlizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues".***

Qe nga data 12.12.2020, kur eshte publikuar, njoftimi per kontrate dhe dosja e tenderit per proceduren e prokurimit me titull ***"Furnizim me insulina analoge nga lista esenciale" lot 1 dhe 3,*** me nr prok : 206-20-8397-1-1-1, ku kompania jone eshte kualifikuar si e pergjegjeshme ne te gjitha aspektet, nenkupton qe nuk kemi te bejme me emergjenc ekstreme, kemi te bejme me keqperdorim dhe abuzim te paras publike, kemi te bejme me amnistim te pergjegjesis penale, kemi te bejme me keqperdorim te pozites zyrtare dhe me mashtrim ne prokurim publik.

Kompania jone ka ofertuar me produktin i cili tregetohet ne tere globin dhe ne tere shtetet anetare te BE-se.

Neni 70, i LPP-se shum kjarte flet per certifikatat qe kane te bejne me kualitetin dhe cilesin e produkteve dhe obligimin ligjore te AK-ve qe certifikatat e tilla do te duhej te pranohen por quditerisht, AK - MSH, ne asnje rrethane nuk e trajton kete dispozit ligjore. Fakti eshte qe e njejta ekziston dhe do te trajtohen nga organe tjera ligj zbatuese.

"Po qe se autoriteti kontraktues kërkon dorëzimin e certifikatave të hartuara nga organet e pavarura me të cilat vërtetohet përputhshmëria e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, autoriteti kontraktues do t'u referohet sistemeve për sigurimin e cilësisë që: (i) bazohen në standardet përkatëse Kosovare, Evropiane ose ndërkombëtare dhe (ii) të certifikuara nga organet që kryejnë veprimtaritë e tyre në pajtim me ato standarde për ushtrimin e aktiviteteve të tyre të certifikimit lidhur me aktivitetet e certifikimit. Autoriteti kontraktues do t'i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ certifikuespavarësisht nga vendi, nëse organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i BE-së ",

Pretendimi -2.

Vet OSHP, ka nxjerr disa vendime. Vendimi i fundit ka numrin. 596/22, i dates 21.12.2022, per kete procedur te prokurimit.

Ne te njejtitn vendim eshte obliguar AK ¦ MSH, qe te respektoi vendimin paraprak me nr. 397-409/22. Pra tani ka kaluar mbi 1 muaj dhe AK - MSH, ende nuk ka zbatuar vendimin tuaj, perkundrazi Zyrtaret Pergjegjes te Prokurimit te AK - MSH tentojn ti ikin pergjegjesise duke perdorur cdo forme per manipulim dhe mashtrim.

Ne vend se te behet Rivleresimi sipas vendimit 596/22 te OSHP-se i dates 21.12.2022, AK- MSH ne te njejten dite zhvillon Procedure te Negociuar pa Publikim te Njoftimit per Kontrate.

Po ti referoheni Vendimit te Refuzimit te kerkeses tone per ri shqyrtim, Zyrtari i Prokurimit tenton te arsyetoje veprimin duke dhene shifra te paverteta duke potencuar se AK -MSH per lotin 1 dhe 2 ka arritur zbritje ne total prej 89,078.55 €, por e verteta qendron se dallimi ne qmim eshte ne vlere prej 7.621,12 €.

Zyrtari Pergjegjes i prokurimit, e fsheh faktin se permes ketyre procedurave te prokurimit eshte shkaktuar demi material rreth 1,000,000.00 €. Ku kompania jone cmimin per lotin 1 dhe 3 e ka patur mbi 400,000.00 €, me te ulet, perfshire edhe cmimin e kontratave tjera te negociuara dhe te nenshkruara. Per me teper edhe delegimi i dy procedurave tek UNOPS dhe pagesa per sherbime ne vleren prej 7%, ne UNOPS. Pra ne kete forme nuk do duhej te lejehoj apo amnistohej abuzimi me parane publike.

Ne si kompani permes kerkeses per ri shqyrtim kemi kerkuar zbatim te vendimeve te OSHP- se, kundrejt procedures se rregullt e zvarritur qe nga viti 2020, perkatesisht ri vleresim te ofertes sone meqe ne e plotesojme cdo kerkese te kualifikimit dhe kjo gje eshte konfirmuar edhe nga vet OSHP.

AK - MSH, edhe kete kerkese nuk e trajton fare. Perkunder faktit se ne vendime te OSHP- se, AK - MSH, eshte obliguar qe brenda periudhes kohore prej 10 diteve ti rivleresoi procesin e prokurimit, rrjedhimisht nuk eshte ndermarr ndonje veprim dhe kete e pohon vet zyrtari tani pergjegjes i prokurimit (Berat Marmullaku) permes shkreses se dates 27.01.2023.

Organi Shqyrtues i Prokurimir, perkatesisht paneli shqyrtues detyrimisht do duhej t'izbatonte dispozitat e nenin 105, te LPP-se, te urdheroi AK-ne, qe te respektoi vendimet paraprake, perkatesisht te aplikohet dispozitat e nenit 131, te LPP-se, ku percaktohet: *OSHPfa do të vendosë një gjobëprej jo mëpaksepesëmijë (5.000) Europër autoritetin kontraktues që nukzbaton një urdhër ose për mosrespektimin e urdhrit të OSHP-së brenda pesë (5) ditëve".*

Kompania jone, ne vazhdimesi ka njoftuar AK-ne, dhe OSHP-ne, si dhe organet tjera lidhur me shkeljet ligjore te procedurave te prokurimit qe kane te bejne me insulina analoge, ku edhe tani AK, lejohet te nenshkruaj kontraten e katert, te negociuar vetem me nje OE, -perkunder, vendimeve te nje pas njeshme te OSHP-se, te cilat kane konstatuar shkeljet e ligjit tani me kete e konfirmon edhe vendimi nr. 67/2022, i dates 30.12.2022, i KRPP-se. Organe keto zbatuese te ligjit per Prokurim Publik.

Permes procedures se negociuar pa publikim te njofiimit per kontrate AK - MSH, ka lidhur kontrate njeburimore me kompanine e cila disponon monopolin tani e rreth 20 vite, perkunder faktit se produkti jone eshte produkt i tregetuar dhe licencuar nga pothuaja se te gjitha shtetet anetare te BE-

se, sic parashifet edhe me dispozitat e nenint 70, te LPP-se. Quditerisht kjo dispozit ne vazhdimesi nuk raportohet nuk interpretohet dhe nuk gjykohet.

Incimi Procedures Emergjente te Negociuar pa publikim te njoftimit per kontrate eshte shkelje e rende e nenit 35 te LPP-se perkatesisht paragrafi 2.1 (pika iii), *"nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivisht të verifikueshme të cilat nuk kanëpasur mundësi tëparashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj.* ***Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues. "***

Pasi keto rrethana jane krijuar direkt nga zyrtaret pergjegjes te AK-MSH, dhe keto veprime i atribohen vetem zyrtarve pergjegjes ne AK-MSH, sepse nuk eshte respektuar asnje vendim i Organit me te larte te prokurimit (OSHP), qe do te thote qe kete situate zyrtare te AK- MSH e kane krijuar qellimisht vetem per te favorizuar nje OE te caktuar.

Pretendimi - 3.

Procesin e rrëgullt te ketije aktivitetit te prokurimi AK - MSH, e ka para vete tani e me shume se dy vite. Gjate tere kesaj kohe nuk ka respektuar vendimet, urdherat, ndeshkimet dhe gjobat, ku perfshihen vendime te OSHP-se, KRPP-se edhe vendimi i Gjykates Themelore, departamentin perkates. Perkunder ketij fakti, AK - MSH, lejohet te inicoj procedur te negoiciuar pa publikim te njoftimit per kontrate, vetem me nje operator ekonomik duke shkelur cdo parim dhe cdo dispozit dhe cdo ligj te mundshem.

Inicimi i kesaje procedure te prokurmit perveq shkeljeve te argumenutara me kete ankese dhe ankesat paraprake paraqet edhe keto shkelje ligjore sic jane:

Neni 42 Njoftimi i Tenderuesve / Kandidatëve - dispozit e rregullores nr. 001/2022 RKPP, rregulla keto qe nuk mund te anashkalohen perkundrazo do duhej te raportohen.

42.1 Të gjithë tenderuesit/kandidatët, duhet të informohen nga AK, përmes publikimit të Formularit B58 "Njoftimit mbi Vendimin e AK",

42.2 ***Në procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, tenderuesit/kandidatët dhe çdo palë e interesuar duhet të informohen nga AK përmes publikimit të Formularit B58 - "Njoftimit mbi Vendimin eAK" dhe Njoftimitpër dhënie të kontratës (B08) njëkohësisht, dhe nga i cili publikim fillojnë afatet kohore për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave.***

42.3 Formulari B58 duhet të përmbajë vendimin mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe letrat standarde përkatëse për Tenderuesit me arsyetimet e nevojshme.

42.4 ***Pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave në Njoftimin mbi Vendimin e AK(B58),*** *Autoriteti Kontraktues obligohet të përgatit draftin e kontratës .dhe nënshkruaj ate brenda 30 ditëve kalendarike.*

42.5 Data e publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK, respektivisht njoftimit të

tenderuesve/kandidateve përbën:

a. Datën kur të gjitha informatat në lidhje me aktivitetin e prokurimit (përveç informatave sekrete të biznesit) janë në dispozicion për palet e interesit.

42.6 Data e njoftimit të tenderuesve/kandidateve është "dila 0" e 5 ***ditëve të obligueshme tëperiudhës "nëpritje".***

Pra AK MSH, fillimisht lidhe kontrate emergjente dhe ate me daten .18.01.2023, ndersa me daten 19.01.2023, publikon njoftimin per dhenie te kontrates.

Keto jane shkelje te renda dhe te sanksionuara te cilat do te duhej ti raportoi edhe OSHP, pasi qe paraprakisht AK, nenshkrun kontraten me daten 18.01.2023, perderisa me daten 19.01.2023, publikon njoftimin per dhenie te kontrates, rrjedhimisht AK - MSH, perkunder faktit se eshte e obliguar ti respektoia afatet kohore edhe me vendim te OSHP-se por edhe me dispozita ligjore, oferten tone fare nuk e rivlereson.

Prate gjitha keto veprime kunderligjore ne kuptim te nenit 130, te LPP-se, paragrafi 3, OSHP dhe paneli shqyrtues do duhej ta njoftoj Ministrin e Puneve te Brendeshme me veprimet penale dhe shkeljet ligjore dhe zhvillim te hetimeve te metutjeshme.

Neni 48, par 7 - Rastet urgjente - dispozit e rregullores nr. 001/2022 RKPP

48.1 Situatat dhe rastet emergjente kategorizohen në:

a. emergjencë ekstreme; dhe

b. urgjenca.

48.2 Për rastet e emergjencës ekstreme - ekziston mundësia të përdoret procedura e negociuarpapublikuar njoftimin e kontratës, neni 35.2.1(iii) i LPP-së. Kjoprocedurë mund të zhvillohet me një ose me shumë Operatorë ekonomik të zgjedhur nga autoriteti kontraktues 48.3 Kushtet dhe rrethanatpër përdorim të procedurave emergjente janë si në vijim:

a. ***Domosdoshmëri strikte e zhvillimit të një aktivitetiprokurimi në baza emergjente,***

b. ***Motivuar nga ngjarje të verifikueshme në mënyrë objektive që nuk ishin të parashikueshme nga autoriteti kontraktues,***

c. ***Nuk mund t'i arrij afatet kohore të kërkuara, dhe***

d. ***Rrethanat emergjente nuk i atribuohen veprimeve neglizhente apo të qëllimshme ose mosveprimeve të autoritetit kontraktues.***

Pra te gjitha keto dizpozita ligjore i atribohen veprimeve kunderligjore te AK-se, pasi qe nejemi kualifikuar si kompani e pergjegjeshme fillimisht nga vet AK, pastaj OSHP, KRPP dhe se fundmi nga Gjykata Themelore ne Prishtine - Departamenti Administrativ.

Pretendimi - 4.

Pra te gjitha keto dizpozita ligjore i atribohen veprimeve kunderligjore te AK-se, pasi qe ne jemi kualifikuar si kompani e pergjegjeshme fillimisht nga vet AK, pastaj OSHP, KRPP dhe se fundmi nga Gjykata Themelore ne Prishtine -• Departamenti Administrativ.

Pretendimi - 4.

Neni 97 Shkeljet e rënda dispozit e rregullores nr. 001/2022 RKPP.

97.1 Shkeljetërëndakonsiderohen:

«.xL Mos.respektimi apo shkelja e parimeve themelore të prokurimit publik të percaktuar me LPP. Shkeljet e parimeve themelore përfshijnë, vendosjen e kritereve apo dëshmive jo në përputhje me LPP apo përshtatjen për një ofertues të caktuar, trajtim jo të barabart të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, përveç specifikimit teknik që bie në përgjegjësinë e Njësisë së kërkesës.

e. Mos respektimi i rregullave për trajtimin e kërkesave për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues.

f. Mos zbatimi i nenit 30.4 të Rregullores së Prokurimit Publik nga zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe si rrjedhojë skadimi të afateve kohore të vlefshmërisë dhe sigurisë së tenderëve.

g. Në qoftë se në periudhën brenda një viti i shqiptohen dy (2) vërejtje me shkrim për shkelje të lehta nga KRPP.

h. Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe KRPP-së

k. Anulimi i aktiviteteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik.

m. Kontrata publike është nënshkruar gjatë periudhës së pritjes sipas nenit 26 të Ligjit të Prokurimit Publik apo gjatë periudhës së vënies së ndonjë mase të përkohshme të urdhëruar nga OSHP.

o. Nëse ka prova të mjaftushme që dëshmojnë për sjellje të gabuar apo jo profesionale të një zyrtari të prokurimit ndaj operatori ekonomik apo ndaj cilit do person gjatë ushtrimit të procedures së prokurimit.

p. Mosrespektimi i afateve kohore në nxjerrjen e vendimit në kërkesa për rishqyrtim dhe afateve kohore në rast të ankesave në OSHP.

Pra megjithese jane shkelur te gjitha keto dispozita ligjor, OSHP bazuar ne nenin 99, te LPP-se, eshte subjekt i zbatimit te te gjitha dispozitave ligjore dhe pergjegjese per zbatimin e procedurave per shqyrtimin e prokurimit kompania jone kerkon qe OSHP te ushtroj ndikimin bazuar ne ligj, te nxjerret URDHER, per zbatim te vendimeve te pa zbatueshme dhe shkeputjen e kontrates se dates 18.01.2023, si te kunderligjeshme.

Prandaj, pas paraqitjes se ketyre fakteve dhe argumenteve, kerkojme nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, qe mos ta lejoje AK-MSH te sillet sikur kjo procedure(Emergjente) nuk ka te beje asgje me proceduren e prokurimit qe eshte ne proces, duke injoruar vendimin e fundit te OSHP-se nr. 596/22 ku procdura Emergjente eshte inciuar dhe Kontrata eshte nenshkruar brenda afatit kohor te dhene nga OSHP per Rivleresim te aktivitetit te prokurimit qe eshte ne proces.

Kerkojme nga OSHP qe te nxjerre:

URDHERESE

APROVOHET, ankesa e OE "Pharma Leader L.L.C." si e bazuar dhe te URDHEROHET AK-MSH qe ta anuloje Kontraten e Nenshkruar per Proceduren Emergjente pa Publikim te Njoftimit per Kontrate dhe te Urdherohet te zbatoj vendimin e OSHP-se nr. 596/22 te dates 21.12.2022..

Poashtu te kerkohet nga KRPP qe te revokohet Certifikata e Prokurimit ndaj zv. te Udheheqesit ne Divizionin e Prokurimit z. Berat Marmullaki, i cili edhe pas verejtjes me shkrim te marre nga KRPP, vazhdon edhe me tutje me shkelje te LPP.

Provat:

- Vendimi 240/21 - nxjerr nga OSHP;
- Vendimi 397-409/22 - nxjerr nga OSHP;

Vendimi 596/22 - nxjerr nga OSHP;

Vendimi 67/22 i KRPP-se per anulim te certefikates dhe verejtjes se zyrtareve te MSH-se;

- Njoftimi per dhenien e kontrates date 19.01.2023;

Kontrata emergjente date 18.01.2023;

Vendimet e Gjykathes Themelore Departamenti administrativ ku padia dhe kerkese padia eshte hedhur si e pa lejuar

- Shkresa e derguar ne KRPP-se

Vendimi i AK-se lidhur me kerkesen per ri shqyrtim te ketij AP date 24.01.2023 dhe Shkresa - pergjigja e dates 27.01.2023, te kerkeses per ri shqyrtimt te procedurese se rregullt - hapur

Vendimi i AK-se lidhur me kerkesen per ri shqyrtim te ketij AP date 24.01.2023 dhe Shkresa - pergjigja e dates 27.01.2023, te kerkeses per ri shqyrtimt te procedurese

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

ARSYETIM

AK-MSh sipas kërkesës për tenderim nga Njësia e Kërkesës, bazuar ne insulinave, sigurimin e mos ndërprerjes se furnizimit dhe domosdoshmërisë p 15,000 pacienteve insulinvartes, jemi te detyruar për kontraktimin e këtyre kundërtën dështimi i kontraktimit dhe furnizimit me Insulina Analoge, shëndetin publik te qytetareve te vendit.

Para tenderimit emergjent e kemi konsultuar Listën e AKPPM-se mbi produkt Autorizim Marketing, konform legjislacionit ne fuqi.

Ministria e Shëndetësisë obligohet qe te zbatoj Ligjin NR. 04/L -190 për Pr Medicinale, si dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2022 qe është ne fuqi.

Si Divizion i Prokurimit ne MSh, duke marre parasysh interesimin tuaj për inkurajon qe ta beni regjistrimin e produkteve ne AKPPM konform legjislacio ti regjistroni produktet, do ju ftojmë dhe mund te merrni pjesë ne tenderët e M sigurojmë se do te jeni i barabarte ne konkurrencë me operatoret e tjerë konforn

Autoriteti Kontraktues nga sqarimet e prezantuara me lart vendosi si në vendimi.

Këshille juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankese pranë OSH OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas këtij vendimi.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

1. Vendimi 67/22 i KRPP-se per anulim te certefikates dhe verejtjes se zyrtareve te MSH-se.

2. Aktvendimi i Gjykathes Themelore Departamenti administrativ ku padia dhe kerkese padia eshte hedhur si e pa lejuar.

3. Shkresa e derguar ne KRPP-se.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **PHARMA LEADER L.L.C.**

Përgjigje ne Pretendimi nr.1

Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës nr.57/23 është se AK-MSH ka zhvilluar procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 35 të LPP-së, pasi që sipas OE ankues janë pikërisht veprimet e AK-MSH-së e cila në vazhdimsi duke mos zbatuar vendimet e OSHP-se ka krijuar situatën të ashtuquajtur "emergjente".

Pas analizimit të shkresave të lëndës kemi gjetuer se AK ka njoftuar KRPP-në për përdorimin e e procedurës së negociauar pa publikim të njoftimit për kontratë, duke ju referuar nenit 35.2.1(ii)-mbrojtjes së të drejtave të pronës intelktuale apo industrial dhe drejtave ekskluzive, si dhe nenit 35.2.1- emergjencave eksperteme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivisht të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mudn ësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues.

Mendimi ekspertit shqyrtues është se asnjëra nga këto dy rrethana nuk ekzistojnë në rastin konkret për arsyertuar përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.

Arsyetimi i AK-MSH-së duke u thirrur në nenin 35.2.1(ii)-mbrojtjes së të drejtave të pronës intelktuale apo industriale dhe drejtave ekskluzive, sipas mendimit tonë është i paqëndrueshëm, pasi në këtë rast AK lenë të kuptohet se në gjithë tregun botëror është vetëm një prodhues dhe vetëm një OE në Ksovoë i cili mund të bëjë furnizimin me insulina analoge.

Kjo qështje besojmë se është trajtuar edhe vendosur më herët nga OSHP përmes disa vendimeve dhe vendimit të fundit të OSHP-së nr.596/22.

Lidhur me arsyetimin e AK-së duke ju referuar nenit 35.2.1(iii) emergjenca eksperteme, kjo dispozitë ligjiore me me theks të veqnat e ndalon shfrytëzimin e kësaj dispozite nëse rrethanat që kanë krijkuar situatën emergjente ekstreme mund ti atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues.

Në rastin konkret mendojmë se mos respektimi dhe mos zbatimi i vendimeve të OSHP-së nga AK-MSH ka krijuar rrethanat ku procedura e hapur për furnizim me insulina ka stagnuar, që rrjedhimisht ka krijuar situatën-mungesën e stoqeve të insulinave.

Rrethanat e krijuara, sipas mendimit tonë në plotni mund ti atribuohen veprimeve dhe mos veprimeve të AK-MSH.

Mendimi jonë është se në rastin konkret pretendimet ankimore janë të bazuara dhe se AK-MSH ka bërë shlelje të dispozitave të nenit 35 të LPP-së.

Përgjigje ne Pretendimi nr.2

Pretendimi i dytë ankimorë sipas ankesës 57/23 është se AK-MSH nuk ka respektuar vendimet e OSHP-së nr.394-409/22 dhe vendimin e fundit 596/22.

Mendimi ekspertit është që në rastin konkret AK-MSH nuk ka zbatuar vendimin e OSHP-së 596/22 në vend të rivlerësimit dhe marrjes së vendimit në procedurë të hapur, AK-MSH anashkalon vendimin e OSHP-së ku për të njëjtin prokurim aplikon procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, ku pranon vetëm një ofertë nga vetëm një OE me të cilin edhe nënshkruan kontratë.

Për më tepër gjatë hulumtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës në E-Prokurim tek rubrika Ftesa për tenderim, nuk kemi gjetur dëshmi se AK-MSH i ka dërguar ndonjë OE ftesë për tenderim.

Përgjigje ne Pretendimi nr.3

Pretendimi tjetër ankimorë është se AK ka bërë shkelje të nenit 42 të Rregulores 001/2022 për prokurim publik, pasi që nuk ka repsketuar afatet kohore për periudhat e pritjes/parashtrimit të ankesave.

*42.1 Në **procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë**, tenderuesit/kandidatët dhe **çdo palë e interesuar** duhet të informohen nga AK përmes publikimit të Formularit B58 - "Njoftimit mbi Vendimin eAK" dhe Njoftimitpër dhënie të kontratës (B08) njëkohësisht, dhe nga i cili publikim fillojnë afatet kohore për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave.*

42.4-Pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave në Njoftimin mbi Vendimin e AK(B58), *Autoriteti Kontraktues obligohet të përgatit draftin e kontratës .dhe nënshkruaj ate brenda 30 ditëve kalendarike.*

42.6*-Data e njoftimit të tenderuesve/kandidateve është "dila 0" e 5* ***ditëve të obligueshme tëperiudhës "nëpritje".***

Në rastin konkret AK-MSH një ditë pas publikimit të vendimittë AK-së ka vazhduar me nënshkrimin e kontratës. Vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar dhe se AK nuk ka respektuar afatet kohore të parapara me nenin 42 të rregullores së lartëcekur.

Po ashtu OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje të nenit 48 par.7 pika (b) dhe pika (d)të rregullores 001/2022:

"d.*Rrethanat emergjente nuk i atribuohen veprimeve neglizhente apo të qëllimshme ose mosveprimeve të autoritetit kontraktues."*

Ky pretendim ankimorë për nenit 48 par.7 pika (b) dhe pika (d)të rregullores 001/2022 vlerësojmë se është i ndërlidhur me shkelje të nenit 35 2.1(iii) të LPP-së, ku kemi jemi përgjigjur në përgjigje në pretendimin nr.1 të këtij raporti.

Përgjigje ne Pretendimin nr.4

Në pretendimin e fundit ankimorë OE ankues pretendon se AK-MSH ka bërë shkelje të nenit 97-Shkeljet e Rënda, të rregullores 001/2022 RKPP.

Neni 97 ;

Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe KRPP-së

k. Anulimi i aktiviteteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik.

m. Kontrata publike është nënshkruar gjatë periudhës së pritjes sipas nenit 26 të Ligjit të Prokurimit Publik apo gjatë periudhës së vënies së ndonjë mase të përkohshme të urdhëruar nga OSHP.

o. Nëse ka prova të mjaftushme që dëshmojnë për sjellje të gabuar apo jo profesionale të një zyrtari të prokurimit ndaj operatori ekonomik apo ndaj cilit do person gjatë ushtrimit të procedures së prokurimit.

p. Mosrespektimi i afateve kohore në nxjerrjen e vendimit në kërkesa për rishqyrtim dhe afateve kohore në rast të ankesave në OSHP.

Mendimi jonë është se veprimet e AK-së parqaqesin shkelje të nenit 97 të rregullores së lartcekur në gjitha pikat e lartcekura, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar, dhe sipas kësaj dispozite veprimet e AK-së mund të kosniderohen si Shkelje të rënda.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u nisur nga gjitha këto që u cekën më lart, i rekomandojmë panelit shqyrtues që

kontratën e nënshkruar përmes procedurës së negociuar pa pubklikim të njfotimit për kontratë, në pajtim me nenin 105 të LPP-së lidhur me nenin 132 par1, nënpar.1.1 dhe 1.2. lidhur me nenin 133 par.1 të LPP-së ta shpall kontratën Jo efektive, në të njëjtën kohë rekomandojmë që urdhërohet AK-MSH të zbatoj vendimin e OSHP-së nr.596/22.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **PHARMA LEADER L.L.C.**

Ilir Halili

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA